



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.2057/5 prot.

Tiranë, më 23.08.2023

VENDIM

Nr. 36, datë 23.08.2023

PËR KONTROLLUESIN “ADRA STUDIO SHPK”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Adra Studio sh.p.k.” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 118, datë 06.07.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i zbatimit të detyrimeve, sipas Rekomandimit nr. 14, datë 13.04.2018 (në vijim, “Rekomandimi”) të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kontrolluesin “Adra Studio sh.p.k.”.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS K31716007L, i cili ushtron aktivitetin në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, interesat mbi pronat dhe qiratë e tyre.
2. Në zbatim të Urdhrit nr. 118, datë 06.07.2023 të Komisionerit, grupi i kontrollit, në datën 14.07.2023, është paraqitur në ambientet e deklaruara nga Kontrolluesi në

regjistrin tregtar për të dhënat e subjektit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, por nga verifikimi në vend rezultoi se zyrat nuk ndodhen në adresën e deklaruar. Nëpërmjet numrit të telefonit, është komunikuar me znj. _____, në cilësinë e administratores së shoqërisë, e cila ka njoftuar grupin e kontrollit se prej vitit 2020 e ushtron aktivitetin nga shtëpia, në formën “*home office*”. Të ndodhur në këto kushte, grupi i kontrollit ka kërkuar që përfaqësuesja e Kontrolluesit, në datën 24.07.2023, të paraqitet pranë zyrave të Komisionerit dhe të demonstrojë përmbushjen e rekomandimeve të lëna.

Në datën 24.07.2023, përfaqësuesja e Kontrolluesit është paraqitur fizikisht në institucionin e Zyrës së Komisionerit dhe ka deklaruar se nuk ka përmbushur detyrimet e Rekomandimit, me pretendimin se nuk ka patur dijeni për to, si dhe pasi është në proces mbylljeje të aktivitetit. Përfaqësuesja e Kontrolluesit kërkoi kohë për plotësimin e rekomandimeve dhe dërgimin e tyre.’

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi edhe më përpara ka qenë objekt i kontrollit për përmbushjen e detyrimeve të Ligjit. Nga hetimi administrativ i mëparshëm, Zyra e Komisionerit ka lënë detyra konkrete nëpërmjet Rekomandimit. Për rrjedhojë, argumenti i përdorur nga Kontrolluesi mbi mos pasjen dijeni për detyrimet e Rekomandimit nuk e shmangin nga përgjegjësia ligjore, pasi akti është dërguar në rrugë zyrtare të deklaruar nga Kontrolluesi, konform procedurave ligjore dhe nga ana e Postës Shqiptare nuk është kthyer njoftim i dërguar nga Komisioneri. Gjithashtu, Vendimarrja e Komisionerit është publikuar në faqen zyrtare të institucionit www.idp.al, ku prezumohet e ditur botërisht.

Kontrolluesi gjatë hetimit administrativ ka pretenduar se është në proces të mbylljes së aktivitetit. Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimi i Kontrolluesit nuk qendron pasi nga verifikimi i regjistrin tregtar për të dhënat e subjektit të Qendres Kombëtare të Biznesit, statusi i aktivitetit rezulton aktiv. Si rrjedhojë, Kontrolluesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë, mbart përgjegjësi dhe detyrime të parashikuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se duke marrë në konsideratë vitin e hyrjes në fuqi të Ligjit, vitin kur Kontrolluesi ka nisur aktivitetin (në vitin 2000) si dhe periudhën kohore nga Rekomandimi nr. 14, datë 13.04.2018 i Komisionerit deri në hetimin e ushtruar për verifikimin e zbatimit të tij, ka qenë një kohë më se e mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve Ligjore.

3. Nga analizimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Kontrolluesi, rezulton se nuk janë marrë masa në lidhje me përditësimin e “*Njoftimit*” pranë Zyrës së Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave për të cilat është përgjegjës, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, si dhe në përmbushje të pikës 1 të Rekomandimit, sa i përket rubrikave të formularit, si vijon:

- Deklarimi në rubrikën nr. 3 “*Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”;
- Deklarimi në rubrikën nr. 4 “*Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*”;
- Deklarimi në rubrikën nr. 6 “*Qëllimi i përpunimit*”;
- Deklarimi në rubrikën nr. 7 “*Marrësi i të dhënave personale*”, etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

4. Kontrolluesi, në përmbushje të pikës 2 të Rekomandimit, ka vendosur në dispozicion rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”. Megjithatë, nga shqyrtimi i përmbajtjes së rregullores, konstatohet se ajo i referohet modelit të publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit dhe në të nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një rregulloreje specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

5. Konstatohet se, Kontrolluesi ka lidhur marrëveshje me palë të treta, konkretisht akt - marrëveshja e datës 26.02.2018, me bankën “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a , me objekt “*...kryerja e shërbimit të vlerësimit të pasurive të luajtshme dhe/ose të paluajtshme nga ana e Vlerësuesit, sipas standardeve të vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë së vlerësimit të kërkuar nga Banka, për çdo rast kur Banka, sipas nevojave të saj të shqyrtimit të një aplikimi për kreditim, do të drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet subjektit aplikues për kredi*”.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kontratës konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka parashikuar një dispozitë, në të cilën të parashtrohen detyrimet e palëve mbi përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 19*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, duhet të jenë të përfshira në kontratën dhe/ose aneks kontratën e hartuar dhe nënshkruar mes kontrolluesit dhe përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi (*outsourcing*), që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikojë masat që duhet të marr përpunuesi për të siguruar/garantuar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit edhe në rrugë elektronike.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesja e Kontrolluesit u paraqit në seancën dëgjimore, në të cilën deklaroi se nuk ka kundërshtime mbi konstatimet e grupit të hetimit.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2, të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin e mospërmbushjes së detyrimeve të lëna në Rekomandim, të cilat lidhen me përpunimin e ligjshëm të të dhënave, garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjes së masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 20, 21, 22, 27, 29, 30, 39 pika 1, germat “ç”, “d” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40 000 (dyzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit;
- 4- Kontrolluesi, të marrë masat për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit, duke specifikuar detyrimet midis palëve, si dhe të monitorojë në vijimësi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet me përpunuesit, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
- 5- Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit”, në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
- 6- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
- 7- Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:
 - i. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 4 dhe 5 më sipër;
 - ii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e parashikuar në pikën 6 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

- 8- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

- 9-** Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
- 10-** Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 23.08.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi